

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (1)

Shtete të reja me minoritete të reja

Raporti “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” identifikon tri çështjet më të vështira minoritare të ngritura kur u shkatërrua Jugosllavia - popullata e përzier në Bosnjë-Hercegovinë, minoriteti i numërt serb në Kroaci dhe popullata shqiptare në Kosovë

“Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” është raport i hartuar nga një grup punues i projektit “Iniciativa e intelektualëve”, që ka studiuar shkaqet e shpërbërjes dhe luftërave në territorin e ish-Jugollavisë.

Ky raport, që vjen pas raportit tjetër të po këtij projekti, “Shpërbërja e Jugosllavisë” (një variant i të cilit është botuar si fejtון në “Kohën Ditore” deri në numrin e djeshëm), përqendrohet në çështjen e minoriteteve në shtetet e krijuara me shpërbërjen e ish-jugosllavisë në vitet 1991-1992.

Edhe në hartimin e këtij raporti kanë marrë pjesë ekspertë nga ish-Jugosllavia si dhe ndërkombëtarë, të udhëhequr nga Gale Stokes dhe Drago Roksandiq. Sikur me raportin paraprak, edhe raportin “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” po e sjellim në variantin e shkurtuar.

Konotacioni i fjalës “minoritet”

“Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” përqendrohet në katër tema qëndrore: Pse çështja e minoriteteve ishte aq e rëndësishme, sa ishte real kërcënimi ndaj minoriteteve të caktuara në

shtetet që trashëguan Jugosllavinë, cili ishte qëllimi i Deklaratës islamike të Alija Izetbegoviqit dhe nëse vendimet e Komisionit të Badinterit dhe suksesioni pasues ishin legjitime. Sipas raportit, çështja e minoriteteve në Jugosllavi është zhvilluar për shkak se demokratizimi i qeverisë jugosllave është kombinuar me dëshirën e grupeve etnike të Jugosllavisë që të krijojnë për vete shtete tradicionale kombëtare.

Në komunizëm, nuk ka patur minoritete të njohura nga shteti. Sipas raportit, në atë sistem madhësia e popullatës ose kufijtë e një territori për këtë shkak ishin të rëndësishë më të vogël se sa nën programin socialist, që ishte një përpjekje e qëllimshme nga qeveria socialiste që të eliminojë identitetin kombëtar si identifikuesi kryesor të popujt e Jugosllavisë. Megjithatë, pas kolapsit të komunizmit, popullata dhe përfaqësimi u bënë faktorë kritikë nën programin e demokracisë kombëtare që u vendos.

Fjala “minoritet” që ka pasur një konotacion aq negativ në kohën e komunizmit sa që vetë kushtetuta e Jugosllavisë socialiste i shmangej përdorimit të saj, tash e mori një kuptim të ri, frikësues

për ata persona që jetonin jashtë kufijve zyrtarë të shteteve të tyre kombëtare në krijim. Derisa Jugosllavia shpërbëhej dhe kufijtë shtetërorë vizatoheshin përgjatë vijave etnike, liderët e Serbisë dhe Kroacisë e identifikonin “pronësinë” e atyre shteteve me shumicat e tyre etnike, derisa i identifikonin popullatat e tjera brenda kufijve të vet thjesht si “qytetarë”. Rezultati i këtyre projekteve të ndërtimit të kombit ishte njohje e vetëdijshme e “dallueshmërisë” mes atyre që kanë etnicitet të ndryshëm si dhe e konfliktit ndëretnik.

Raporti “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” identifikon tri çështjet më të vështira minoritare të ngritura kur u shkatërrua Jugosllavia - popullata e përzier në Bosnjë-Hercegovinë, minoriteti i numërt serb në Kroaci dhe popullata shqiptare në Kosovë.

Kështu, çështja kyçe minoritare do të jetë fati i këtyre minoriteteve të reja në shtetet trashëgimtare të Jugosllavisë.

Serbët e refuzojnë statusin e minoritetit

Në raport theksohet që çështja e

shqiptarëve të Kosovës është mbuluar thellësisht në një raport tjetër të Projektit, prandaj raporti “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” qëllimisht nuk e mbulon këtë çështje në detaje.

Në rastin e Bosnjë-Hercegovinës, minoriteti kroat ishte i ndarë rreth asaj se si më së miri mund të mbrojnë veten, duke e marrë parasysh statusin e tyre të ri si minoritet. Disa kroatë ndjenin se përkrahja e një shteti unik dhe të fuqishëm të Bosnjë-Hercegovinës dhe bashkimi me myslimanët e Bosnjës do të ishte mënyra më e mirë për të mbrojtur veten. Të tjerët, posaçërisht ata që jetonin në rajonet e dominuara nga kroatët, nuk pajtoheshin dhe favorizonin bashkimin e tyre me shtetin e posakrijuar kroat, ose së paku krijimin e një rajoni të tyre autonom brenda Bosnjë-Hercegovinës. Çështja e minoritetit kroat brenda Bosnjës përfundimisht është tejkaluar me intervenimin ndërkombëtar dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Uashingtonit më 1994.

Çështja qendrore minoritare në ish-Jugosllavi është ajo e statusit të serbëve si minoritet në shtetet

e posakrijuara. Sipas raportit, në të gjitha rajonet ku serbët e gjetën veten në pozitë të minoritetit u përgjigjën me përkrahje të lidërshit nacionalist në Beograd. Thirrjet për mbrojtje nga këto komunitetet irredentiste u shkonin për shtati politikanëve nacionalistë në Beograd që dëshironin zgjerimin e kufijve të Serbisë. Raporti më tej thekson se “ishin kryesisht serbët ata që justifikonin politikat e tyre agresive duke e refuzuar statusin e minoritetit”. Dikur popullata serbe në Kroaci rroku edhe armët dhe me ndihmën e Ushtrisë jugosllave vendosi rajonet autonome, ndërsa rezultati ishte përhapja e dhunës, spastrimit etnik dhe zhvendosjeve masive të refugjatëve.

Në fund, këto projekte të konsolidimit kombëtar dhe dhuna etnike që ato shkaktuan zgjati për katër vite dhe u ndal vetëm me intervenimin e bashkësisë ndërkombëtare.

(Nesër: Sa kishin rëndësi agjendat e liderëve nacionalistë si Milosheviqi, Karaxhiqi, Tuxhmani dhe Izetbegoviqi? Çka paraqiste Deklarata Islamike e Izetbegoviqi?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (4)

Kryeqyteti i krimit

Më 11 maj të vitit 1920, Franki Yale, hyri në klubin Colosimo me një automatik në dorë dhe e shndërroi Jimin e Madh në një fontanë gjaku. Chicago përnjëherësh mbeti pa mbretin e saj të krimit

Al Capone ishte burrë i martuar dhe kumbarë e kishte gangsterin Johnny Torrio. Në fytyrë i kishte vragat që i kishin mbetur nga zënka me gangsterin tjetër Frankie Golluscio. Në shpirt e kishte dhimbjen për babanë që i kishte vdekur rishtazi. Në këtë kohë, fillim i viteve njëzet, Capone mori një ofertë për të punuar në Chicago për Torriorin.

Chicago, Illinois, ishte vend i përkryer për ta ndërtuar një perandori krimi. Ishte një qytet, të cilin secili mund ta blinte, vetëm a kishte para. Ishte një qytet mizor, brutal. Miliona lopë, qengja e derra thereshin nga njerëzit për

industrinë e mishit. Ishte një qytet komercial, pa apetit për traditën ose “paratë e vjetra”. Në këtë qytet periferik, korrupsioni ishte si mirëdita. Kur Al Capone ka arritur në këtë qytet një ditë të bukur të vitit 1920, krimi i organizuar aty tashmë kishte lëshuar rrënjë. Shefi i krimit të organizuar në këtë qytet ishte Jim Colosimo, të cilin e quanin edhe Big Jim (Jimi i Madh). Ai mbretëronte së bashku me gruan dhe partneren e tij Victoria Moresco, një zonjë hijerëndë. Vetëm nga bizneset e shtëpive publike, ata fitonin nga 50.000 dollarë në muaj që për atë kohë krahasohet me milionë të

sotshëm. Jimi i Madh ishte pronar i klubit të natës “Colosimo”. Shoqërohej me njerëz të famshëm, në mesin e të cilëve edhe tenori Enrico Caruso. Jimi i Madh ishte mburacak. Mbante zinxhirë të nxjerrë jashtë këmishës dhe fryhej me unaza diamanti. Ai kishte vendosur të bashkëpunonte me Johnny Torriorin, sepse Torrio ishte njeri i zgjuar dhe joviolent si mafiozët e tjerë. Torrio ishte ndryshe nga Jimi i Madh: nuk pinte raki, nuk pinte duhan dhe nuk vraponte pas grave të huaja. Johnny Torrio nuk e tradhtonte Annën, gruan e tij. Jimi i Madh, ndonëse me gruan i kishte lidhur edhe biznesi, e kishte një dobësi të madhe: këngëtaren Dale Winter.

Kur Jim Colosimo ishte ndarë me gruan e tij Victoria për t'u martuar me këngëtaren e bukur, ai i kishte humbur shumë kontakte dhe miqësi. Kjo bëri që gangsteri Frank Yale, në klubin e të cilit kishte punuar më parë Al Capone, të shihte rastin për të marrë primatin në Chicago nga New Yorku. Më 11 maj të vitit 1920, Yale hyri në klubin Colosimo me një automatik dhe e shndërroi Jimin e Madh në një fontanë gjaku. Yale ishte njeri që gjithçka donte të bënte me forcë. Ai e kishte vrarë Colosimon para shumë njerëzve.



Jim Colosimo me bashkëshorten e tij Victorian

Policia nuk e pat zor që ta kapte dhe ta arrestonte. Mirëpo, askush nuk guxoi të dëshmonte në gjyq kundër tij. Me Colosimon gjashtë pashë nën dhe, si dhe me Yalen prapa grilave, Johnny Torrio mundi që ta merrte mbi vete gjithë biznesin e qytetit: shtëpitë publike, bastoret, lokalet e bixhozit dhe kafenetë.

(Në numrin e ardhshëm: Kur ia ktheu Al Capone përgjithmonë shpinën ndershmërisë? Si filloi të ngritej në hierarkinë e bandës së Torrios? Kush ishte Jack Guzik? Si i arsyetonte Capone paratë e fituara?)

Gangsterë të tjerë të shquar

Albert Anastasia

Albert Anastasia ka qenë njëri ndër shefat e familjeve më të fuqishme të mafias në Amerikë. Ka arritur në Amerikë si emigrant nga Italia, më 1920, dhe është shquar si një mizor. Nuk ka qenë shef i mirë i mafias, sepse ka qenë i preokupuar të vriste njerëz. Pesë herë e kanë nxjerrë para gjyqit nga viti 1922 - 1933, por asnjëherë nuk kanë mundur ta dënonin, sepse dikush gjithnjë i vriste dëshmitarët. Shënimet për të thonë se gjatë pushtetit të tij si shef i mafias, në emër të tij janë vrarë jo më pak se 400 - 500 njerëz (sic). Ky numër do të mund të ishte edhe më i lartë, sikur një ditë prej ditësh, persona të panjohur të mos e kishin vrarë Anastasia, derisa ai ishte duke u qethur në një dyqan, më 1957. Ka vdekur si 53-vjeçar. Biznesin e tij e ka vazhduar familja Gambino.